



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:157557

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05572592

P.nr.285/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me praktikanten e rregullt Leonita Sadiku, në lëndën penale ndaj të pandehurit P.R., për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.162/2021 të datës 26.11.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 29.03.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Ajtene Zoni, i pandehuri P.R. dhe mbrojtësi i tij avokat Milos Delevic, me datë 29.03.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 15.04.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

P.R., nga i ati Z., e ëma S., e vajzërisë K., i lindur me datë 22.08.2002 në Mitrovicë-Veri, me vendbanim në Rr."T.R", nr. 21, Mitrovicë-Veri, ka të kryer shkollën e mesme ndërsa studion në Fakultetin për Siguri Publike, i pamartuar, student, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I pandehuri deri me datë 05.06.2021, rreth orës 12:10 minuta, në Mitrovicë në Rr. Kral Petri, hyrja nr. ..., ka poseduar në mënyrë të paautorizuar një armë prej me gaz pa numër serik të cilën armë i pandehuri e ka mbajtur në posedim, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armë..

Me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70 e lidhur me nenin 366 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 452 dhe 460 të KPP-së, e:

G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300 euro (*me fjalë: treqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzetë).
Koha e kaluar në mbajtje në Polici nga data 28.03.2024 deri me datë 29.03.2024, i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- II. Në mbështetje të nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të KPP-së, të pandehurit i konfiskohen sendet dhe atë: armë-sprej me gaz. Urdhërohet Policia e Kosovës që sendet e konfiskuara ti shkatërroj sipas procedurave ligjore në fuqi.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumë prej njëzetë (20) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumë prej njëzetë euro (20), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr 162/21 të datës 26.11.2021, kundër të pandehurit P.R. për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata për këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 29.03.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i pandehuri P.R. dhe mbrojtësi i tij me autorizim, avokati Milosh Delevic.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjenë veten fajtor për veprën penale, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë, dhe ka theksuar se i vije keq për rastin që ka ndodhur dhe premtion se më nuk do të përsëritet.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor të dënohet sipas ligjit duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me ligj.

Mbrojtësi i të pandehurit P.R., avokat Milos Delevic, në shqyrtimin fillestar dhe lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ndërsa lidhur me sanksionin penal i ka propozuar gjykatës që si

rrethanë lehtësuese, pasi që nuk ka rrethanë rënduese, ka deklaruar që kemi të bëjmë me sprej e për të cilin as ai vetë nuk e ka ditur se është e ndaluar, se bëhet fjalë për një person të moshës së re, i padënuar më parë, gjithashtu e ka lutur gjykatën që ta përcaktojë një dënim me gjobë pasi që i njëjti është student dhe edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti Fillestar i datës 05.06.2021 me numër të rastit 2021-SA-11; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin P.R., me numër të rastit i datës 05.06.2021; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me numër të rastit 2021-SA-888, i datës 05.06.2021; Raporti i hetuesit A.M., me numër të rastit 2021-SA-111, i datës 05.06.2021; Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i ‘u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 KPRK-së, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vite.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese lidhur me këtë rast, gjykata nuk ka gjetur. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, moshën e re të pandehurit si dhe rrethanat personale duke qenë se i njëjti është student.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t’i parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen të pandehurit të përmbahen nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Gjykata, si në dispozitiv të Aktgjykimit, ka urdhëruar marrjen e sendit, respektivisht një armë-sprej me gaz, duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende që janë rezultat i kryerjes se veprës penale siç vërtetohet më lartë, në mbështetje të nenit 276, par.1 e lidhur me par.2, nënpar.2.1, të KPP-së, ku përcakton se armët të cilat janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 364, deri me 369 të Kodit Penal, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh edhe gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

Lidhur me llogaritjen e kohës së kaluar në heqje të lirisë me datë 28.03.2024 (rreth orës 18:30 minuta sipas raportit të policisë) deri me datë 29.03.2024 kur edhe është mbajtur seanca, në dënimin e shqiptuar, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 79 paragrafi 1 të KPRK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata nuk ka vendosur pasi që një kërkesë e tillë nuk ishte parashtruar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 242, 364, dhe 452 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.285/23, datë 15.04.2024

Procesmbajtësja
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.